



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 33/2020 (JR)
Datë 01.09.2020

Vendim nr. 34 (JR)
Datë 25.11.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 25.11.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 33/2020, datë 01.09.2020, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ndue Gjura, me funksion inspektor pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (sot Këshilli i Lartë Gjyqësor).

OBJEKT: Shqyrtimi i vendimit nr. 266, datë 18.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6 e vijim; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, nenet 136, 136/1, 136/3, 139 e vijim; ligji ndryshues nr. 76/2016, datë 22.07.2016, nenet 136/113/5, 139, 139/2, 179/4, 179/b, 179/b/2, 179/b/5, neni G e vijim; Kodi i Procedurave Administrative, nenet 5, 6, 13, 14, 42, 45, 47, 78, 87, 50, 84 e vijim; ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenet 63, 4/6, 47, 3/16, 58/1, 66/1/c e vijim; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, neni 46 e vijim; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë”, nenet 1, 3, 5, 7, 11, 12, 22, 36, 61, 62, 64, 65 e vijim.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016), dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj dhe shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për tërheqjen e ankimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes (JR) nr. 33/2020, datë 01.09.2020, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Ndue Gjura ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar inspektor pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (sot Këshilli i Lartë Gjyqësor), për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit, më datë 08.01.2020, i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për heqje dorë nga detyra për arsye personale, të moshës dhe gjendjes jo të mirë shëndetësore.
3. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) me vendimin nr. 35, datë 23.01.2020, vendosi deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Ndue Gjura, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të dorëheqjes së motivuar të tij nga ky status.
4. Në vijim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar të z. Ndue Gjura, me vendimin nr. 266, datë 18.06.2020.

II. Vendimi i Komisionit

5. Komisioni, me vendimin nr. 266, datë 18.06.2020, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës vendosi:
 1. *Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Ndue Gjura.*
 2. *Ndalimin e emërimit të z. Ndue Gjura si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*
 3. *Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr.84/2016 [...].*

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

6. Kundër vendimit të Komisionit nr. 266, datë 18.06.2020, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Ndue Gjura duke parashtruar shkaqet përkatëse të ankimit dhe duke kërkuar nga Kolegji që, pasi të shqyrtojë ankimin, të vendosë prishjen e pikës 2 të këtij vendimi dhe pushimin e gjykimit.

IV. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit për tërheqjen e ankimit dhe pushimin e gjykimit

7. Më datë 23.11.2020, subjekti i rivlerësimit Ndue Gjura depozitoi personalisht pranë Kolegjit një kërkesë “Për tërheqjen e ankimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes (JR) nr. 33/2020, datë 01.09.2020”, e cila është protokolluar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 23.11.2020.
8. Në këtë kërkesë, subjekti ka deklaruar se vullneti i tij për heqjen dorë nga gjykimi në Kolegji është i paekuivok, duke mos konsideruar të nevojshme të parashtrrojë shkaqe për tërheqjen e ankimit.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

9. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi u njoh me ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Ndue Gjura, shqyrtoi kërkesën e tij për tërheqjen e ankimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes dhe konstatoi vullnetin e ankuesit për heqjen dorë nga ankimi dhe gjykimi në Kolegji, arsyeton sa vijon.
10. Kushtetuta, në nenin 179/b, pika 5 e saj, parashikon: *Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...], dhe sipas kësaj dispozite kushtetuese, janë subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, ata që vënë në lëvizje Kolegjin për kontrollin e vendimeve të Komisionit, mbi bazën e ankimit të paraqitur prej tyre.*
11. Sipas nenit 179/b, pika 10 e Kushtetutës, procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit.
12. Në nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet: *Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2 i Aneksit. Në referencë të këtyre dispozitave kushtetuese, sidomos parashikimeve në nenin 179/b, pika 10 e Kushtetutës, Kolegji çmon se instituti i heqjes dorë nga ankimi i subjektit të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, do të trajtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*
13. Nisur nga fakti që në dispozitat e veçanta të ligjit nr. 84/2016 nuk gjenden rregullime të posaçme për t'i dhënë zgjidhje një situatë si kjo e rastit objekt gjykimi, Kolegji vëren se në nenin 4, pika 6 e këtij ligji, parashikohet: *Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në*

ligjin “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

14. Në këto kushte, kur si Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 nuk i rregullojnë drejtpërdrejt procedurat në lidhje me institutin e heqjes dorë nga ankimi, në referencë të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, konkretisht të nenit 1, pika 2 ku parashikohet se: *Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe – dhe të nenit 44 të tij, në të cilin parashikohet se: Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj*, trupi gjykues çmon se për të zgjidhur situatën konkrete, duhet t’u referohet dispozitave të posaçme të Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë institutin e heqjes dorë apo të tërheqjes së ankimit dhe pasojat ligjore që prodhon ushtrimi i kësaj të drejte të ankuesit.

Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit Ndue Gjura ka tërhequr ankimin e paraqitur prej tij kundër vendimit nr. 266, datë 18.06.2020, të Komisionit dhe në zbatim të parimit se ankuesi është titullari i vetëm i këtij mjeti procedural për të kundërshtuar vendimin e Komisionit objekt gjykimi në Kolegj, trupi gjykues vlerëson se gjendet para zbatimit të detyrueshëm të nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin përcaktohet pasoja juridike e heqjes dorë nga ankimi, sipas këtij parashikimi: *Në çdo fazë të gjykimit të çështjes në apel, ankuesi ose përfaqësuesi i tij mund të heqë dorë nga ankimi. Në këtë rast, vendoset pushimi i shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit.*

15. Për sa më sipër, trupi gjykues, duke konstatuar heqjen dorë nga ankimi të subjektit të rivlerësimit, çmon se Kolegji nuk ka më objekt shqyrtimi për çështjen për të cilën është vënë në lëvizje dhe, në zbatim të dispozitës së cituar më lart, duhet të pushojë shqyrtimin e kësaj çështjeje. Kolegji e sheh të nevojshme të nënvizojë faktin se i njëjti qëndrim është mbajtur edhe në çështje të mëparshme, me situatë të ngjashme procedurale.
16. Në vijim, Kolegji vlerëson se për shkak të parashikimit të nenit 451, germa “b” e Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: “Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur: nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr”, vendimi i Komisionit nr. 266 datë 18.06.2020, për të cilin ishte ushtruar ankimi i cili është tërhequr më pas prej subjektit të rivlerësimit, merr formë të prerë, fakt i cili duhet të deklarohet prej Kolegjit në këtë vendim, për të qartësuar marrëdhënien e subjektit me procesin e rivlerësimit.
17. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi e gjykoi çështjen në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi se shqyrtimi i çështjes në Kolegj duhet të pushohet për shkak të tërheqjes së ankimit prej subjektit të rivlerësimit.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në nenet 451 germa “b” dhe 463 të Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Ndue Gjura, kundër vendimit nr. 266, datë 18.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkak të tërheqjes së ankimit.
2. Të deklarojë marrjen e formës së prerë të vendimit nr. 266, datë 18.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ndue Gjura.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.11.2020.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, nuk jam dakord me vendimin nr. 34, datë 25.11.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim: “Kolegji”), për pushimin e shqyrtimit në Kolegji të çështjes që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Ndue Gjura, kundër vendimit nr. 266, datë 18.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) për shkak të tërheqjes së ankimit.
2. Komisioni, me vendimin nr. 266, datë 18.06.2020, ka vendosur: *Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Ndue Gjura. Ndalimin e emërimit të z. Ndue Gjura si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare [...].*
3. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pranë Kolegjit subjekti i rivlerësimit Ndue Gjura, duke kërkuar prishjen e pjesshme të këtij vendimi, përkatësisht për pikën 2 të dispozitivit ku shprehimisht parashikohet *ndalimi i emërimit të subjektit të rivlerësimit Ndue Gjura si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.*
4. Nga subjekti i rivlerësimit Ndue Gjura, përpara shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi është paraqitur në Kolegji një kërkesë, më datë 23.11.2020, nëpërmjet së cilës subjekti i rivlerësimit *ka kërkuar tërheqjen e ankimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes në Kolegji.*
5. Shumica e trupit gjykues, pasi u njoh me kërkesën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për heqjen dorë nga ankimi, vendosi: *Pushimin e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Ndue Gjura, kundër vendimit nr. 266, datë 18.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkak të tërheqjes së ankimit. Të deklarojë marrjen e formës së prerë të vendimit nr. 266, datë 18.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ndue Gjura.*
6. Me këtë vendim nuk jam dakord për këto arsye:
 - 6.1 Procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë kryhet mbi ato dispozita ligjore që nuk parashikojnë pushim të gjykimit të çështjes në Kolegji.
 - 6.2 Ligji nr. 84/2016, përkatësisht neni 66, pika 1 e tij ka parashikuar se, pas shqyrtimit të çështjes në Kolegji, *trupi gjykues vendos lënien në fuqi të vendimit, ndryshimin e vendimit apo prishjen e vendimit të Komisionit.* Pra, vetë ligji ka përcaktuar në mënyrë shteruese vendimmarrjet e mundshme të Kolegjit. Kjo dispozitë nuk parashikon ndonjë urdhëresë për pushimin e gjykimit të çështjes.
 - 6.3 Neni 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

6.4 Nëse i referohemi nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

7. Referuar dispozitave më sipër, në asnjë rast ligjvënësi nuk ka parashikuar alternativë tjetër, përveç lënies, prishjes dhe ndryshimit të vendimit të Komisionit. Krijimi i një alternative tjetër, siç është pushimi i gjykimit të çështjes, është një iniciativë e marrë nga trupi gjykues, që shkon përtej asaj që parashikon ligjvënësi. Prandaj jam kundër kësaj alternative për pushimin e gjykimit të çështjes.
8. Nëse duhet të jemi korrektë për atë që parashikon ligjvënësi, sipas dispozitave të mësipërme të ligjit nr. 84/2016, nuk duhet të orientohemi në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kodin e Procedurës Civile, pasi procesi i rivlerësimit ka karakter administrativ, për rrjedhojë dispozitat e mësipërme të orientojnë në Kodin e Procedurave Administrative dhe në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.
9. Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, kanë paraqitur qartë procedurat për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Këto dispozita kanë parashikuar ndër të tjera, se gjykatat përgjatë shqyrtimit të çështjeve administrative, duhet të zbatojnë parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të drejtave e interesave të ligjshëm të personave privatë. Këto dispozita, kanë parashikuar edhe rastet kur mosparaqitja e palëve, si dhe tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera.
10. Në rastin në gjykim, trupi gjykues në momentin e shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, në fillim duhet të ishte ndalur në shqyrtimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, nëse shprehja e vullnetit të tij ishte e ligjshme për heqje dorë nga shqyrtimi i ankimit, pastaj të vendoste sipas alternativave që ka parashikuar neni 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe në asnjë rast pushimin e gjykimit.

Gjyqtare

Natasha Mulaj

nënshkrimi